

Tiranë, më 05.05.2020

K Ë R K E S Ë

NGA: **Qëndresa Qytetare**, një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me Vendimin Nr. 1120, datë 15.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Sheshi “Avni Rustemi”, Rruga “Hoxha Tahsim”, Pallati “Vjero”, Ap. A17, Tiranë, me email: qendresaqytetare@gmail.com dhe nr. cel: (+355) 69 22 03 074, përfaqësuar nga **Rigels Xhemollari** dhe **Marash Logu**.

LËNDA: Kërkesë për thirrjen e një seance dëgjimore me Ministren e Arsimit znj. Besa Shahini dhe përfaqësues të studentëve, lidhur me zgjedhjet në universitetet publike.

DREJTUAR: **Znj. Fatjona DHIMITRI**
Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

PËR DIJENI: **Znj. Mirela KUMBARO**
Zëvendëskryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Znj. Vasilika HYSI
Zëvendëskryetare e Kuvendit të Shqipërisë.

Znj. Besa SHAHINI
Ministër i Arsimit dhe Sportit.

E nderuar znj. Dhimitri,

Në datën 26 Mars 2020, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka caktuar datën e zgjedhjeve për drejtuesit e universiteteve publike në datën 12 Qershor 2020. Në kohën e caktimit të kësaj date zgjedhesh, Këshilli i Ministrave kishte shpallur gjendjen e fatkeqësisë natyrore deri në datën 23 Prill 2020. Por, pikërisht në këtë datë, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar kërkesën e Këshillit të Ministrave për zgjatjen e gjendjes

së fatkeqësisë natyrore deri në datën 23 Qershor. Pra, zgjedhjet në universitetet publike do të zhvilloheshin ndërkohë që vendi vazhdonte të ishte në gjendjen e fatkeqësisë natyrore.

Në datën 30 Prill, Ministria e Arsimit nxori një urdhër sipas të cilit studentët që diplomohen do të kthehen në auditore gjatë muajit Qershor, pa përcaktuar një datë, ndërkohë që studentët e tjerë do të ktheheshin në 25 Gusht. Ndërkohë, sa i përket zgjedhjeve në universitete, Ministria deklaroi dhe se Ministria shpall vetëm datën e zgjedhjeve, ndërsa zhvillimi i tyre është çështje e brendshme e universiteteve.

Neni 170, pika 6 e Kushtetutës së Shqipërisë parashikon se gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore nuk mund të zhvillohen zgjedhje për Kuvendin, organet e pushtetit vendor dhe Presidentin e Republikës. Është e kuptueshme që për sa kohë kohë Kushtetuta ndalon zhvillimin e zgjedhjeve për organet më të rëndësishme të Republikës, zhvillimi i zgjedhjeve për struktura, të cilat janë më poshtë në hierarkinë shtetërore nuk mund të bëhet. Kjo pasi, qëllimi i kushtetutbërësit ka qenë pikërisht që gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shmangeshin situata të tilla që shtojnë rrezikun për jetën, shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve, në rastin konkret të studentëve dhe pedagogëve.

Neni 37 i ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” parashikon se studentët e universiteteve publike përfaqësohen në Senatin Akademik në masën 10 përqind. Ndërsa, nenet 39 dhe 42 parashikojnë se votat e studentëve për zgjedhjen e rektorëve dhe dekanëve llogariten në masën 10 përqind të totalit të votave. Pra, ligji për arsimin e lartë garanton të drejtën e studentëve për të zgjedhur drejtuesit e universiteteve dhe për t’u zgjedhur në Senatin Akademik. Në kushtet kur Ministria ka urdhëruar kthimin vetëm të studentëve që diplomohen në Qershor, ndërsa gjithë të tjerët në 25 Gusht, kjo do të thotë se më shumë se 60% e studentëve nuk do të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre ligjore.

Në këtë pikë, duhet shtuar edhe fakti që për shkak të masave të marra nga Qeveria, studentët dhe pedagogët janë në pamundësi për të organizuar aktivitete apo takime me qëllim shpalosjen e ideve dhe platformave të tyre. Kjo është një e drejtë e përcaktuar shprehimisht në rregulloret e universiteteve për zgjedhjet, dhe vecanërisht e rëndësishme pasi zgjedhjet duhet të jenë një mundësi për të bërë bilancin e katër viteve të shkuara dhe paraqitur vizionin për katër vitet e ardhshme. Për më tepër, që studentëve që duan të zgjidhen në Senatin Akademik iu është kërkuar një numër i caktuar nënshkrimesh nga studentë mbështetës, të cilat në kushtet e pandemisë janë të pamundura të mblidhen pasi do të shkëlqin rregullat e vendosura nga Qeveria dhe vinin seriozisht në rrezik jetën dhe shëndetin e studentëve.

Sa i përket situatës në Universitetin e Tiranës, i cili për shkak të historisë dhe kapaciteteve të tij është universiteti më i rëndësishëm dhe më i madh në vend, ia vlen të ndalemi shkurtimisht. Në datën 30 Prill, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve pranë UT ka shpallur zgjedhjet dhe datat përkatëse për regjistrimin e kandidatëve. Ky vendim përmban në vetvete disa problematika ligjore. Neni 5 i Rregullores së UT për zgjedhjet parashikon se shpallja e zgjedhjeve bëhet nga Rektori, i cili është autoriteti më i lartë akademik sipas nenit 39 të ligjit për arsimin e lartë. Ndërsa, 3 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve nga Rektori, zgjidhet Komisionit Institucional i Zgjedhjeve nga Senati Akademik. KIZ-i ri zgjedh më pas anëtarët e Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultete. Është e qartë se vendimi i marrë nga ish-anëtarët e KIZ-it është në kundërshtim me Rregulloren e Universitetit.

Por, ajo cka e bën edhe më problematike situatën në Universitetin e Tiranës është parashikimi i nenit 38 të Rregullores së UT për zgjedhjet, i cili sanksionon shprehimisht se zgjedhjet janë të pavlefshme në rast të fatkeqësive natyrore që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim. Në kushtet kur Ministria ka urdhëruar rikthimin e 60% të studentëve në auditore në datën 25 Gusht është e qartë se pjesëmarrja e një numri të madh të studentëve në zgjedhje do të jetë efektivisht e pamundur.

Neni 36 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë parashikon se Komisioni parlamentar mund të organizojë seancë dëgjimore me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupimeve të tjera të interesuara. Në kushtet kur zhvillimi i zgjedhjeve në universitetet publike gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore përbën një pengesë reale në realizimin e të drejtës së studentëve për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, kërkojmë thirrjen e një seance dëgjimore në Komisionit parlamentar për çështjet e arsimit me Ministren e Arsimit, përfaqësues të Qëndresës Qytetare dhe studentëve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të përgjigjes Tuaj.


Me konsideratë,

Rigels XHEMOLLARI

()



Marash LOGU

()